



# ANALIZA VJETORE

## 2013

*( Mbi veprimtarine e administrates se Bashkise për vitin 2013 )*

### shkurt - 2014

## *Te nderuar pjese marrës !*

Analiza e sotem ka per qellim, te trajtoje veprimtarine e administrates Bashkise Lezhe, per vitin 2013 dhe konkretisht :

- a. Si jane realizuar ne aspektin sasior dhe cilesor detyrat dhe objektivat e parashikura, per vitin 2013 ne sherbimet ndaj kominitetit, niveli i drejtimit te sektoreve te ndryshem te Bashkise, progresi ne hartimin dhe zbatimin e projekteve te zhvillimit ne infrastrukturen publike, gjithnje ne funksion te rritjes se cilesise se jetes se qytetareve.
- b. Te evidentojme mangesite e konstatuara ne praktiken e punes se administrates, me problematiken me te cilen eshte perballur gjate vitit 2013 kjo administrate.
- c. Ne fund te kesaj analize do te njihemi me disa nga objektivat kryesore te vitit 2014, si viti i parafundit i mandatit katervjecar 2011-2015.

Viti 2013 qe sapo mbyllem ka qene një vit i veçante, per administraten e Bashkise dhe gjithë komunitetin lezhjan, per faktin se :

- Ishte viti i pare i shekullit te dyte pas Shpalles se Paveresise;
- ishte nje vt I lodhshem ne aspektin politik, kjo per aresye te tradites shqiptare, duke qene nje vit elektoral, per zgjedhjet e Pergjithshme;
- ishte viti ne te cilin kriza ekonomike globale, pati ndikimet me te medha se asnjehere tjetër, ne te ardhurat e Bashkise tone.
- viti i rritjes se cilesise se sherbimit ndaj komunitetit, per krijimin e besueshmerise tek institucioni yne dhe Lidershipi,
- vit i cili shenoj, arritje ne administrimin e te ardhurave vendore,
- ishte viti i vazhdimit te projekteve te filluara me pare, ne disa segmente te infrastruktures se qytetit, me objekt zhvillimin urban etj.

Viti 2013 qe kemi mbyllur ishte nje vit i cili vlen te mbahet ne kujtesen tone, jo vetem siç ndodh zakonisht kur arrihen suksese, por vlen te mbahet ne memorien tone, si nje vit ne te cilin ka fillimet e veta nje praktike krejt e re ne sherbimin ndaj komunitetit qytetar.

Ky sherbim cilesor erdhi si rrjedhoje e implementimit te projektit te Zyres me nje Ndalese (One Stop Shop), me ane te ciles u vendosen tete sportele ne sherbim te qytetareve, si një nga modelet më bashkëkohore në shërbim të komunitetit.

Ne kete zyre u permiresuan ndjeshem kushtet e pritjes, akomodimi i vizitoreve, marrja e problematikës, plotësimi e ndjekja e kërkesave dhe ankesave te qytetareve, kthimi i përgjigjeve në kohë, etj.

Ky sherbim ka sjelle një transformim të dukshëm në sensin pozitiv të punës në shërbimin ndaj komunitetit si në aspektin e zgjerimit të llojshmërisë së shërbimeve, cilësisë dhe afatit të kryerjes së tyre.

Pra gjatë vitit 2013, jo vetëm janë përmirësuar të gjitha shërbimet ndaj komunitetit, por gjithashtu është rritur shpejtësia e reflektimit ndaj ankesave dhe shqetësimeve të ngritura

dhe është zgjeruar gama e problemeve që janë marre në konsideratë për zgjidhje. Zyra me një Ndalesë në të cilën janë përfshirë të gjithë sektorët kryesorë të Bashkisë, ka shërbyer në përmirësimin e shërbimit, rritjen e shpejtësisë së veprimit, forcimin e punës në grup, funksionim më të mirë të informacionit për problemet që kanë patur interes për komunitetin, duke i dhënë zgjidhjet ligjore problemeve që kanë shqetësuar banorët.

Që në projektim, kjo zyra është konceptuar si një përqendrim i kapaciteteve njerëzore dhe administrative në shërbim të qytetarëve me qëllim përmirësimin e komunikimit e shërbimit ndaj banorëve, për gjetjen e rrugëve e formave optimale për shkurtimin e kohës së shërbimit.

Cilido që është njohur me këtë mjedis dhe mënyrën e funksionimit të këtij shërbimi, qoftë qytetar vendas apo i huaj, emigrantë apo drejtues të ndryshëm të njësive vendore, kanë shprehur konsideratën, për kushtet që janë krijuar me këtë investim dhe mënyrën e funksionimit të tij. Modeli i kësaj zyre na krahason me vende të zhvilluara të Europës.

Për shërbim ndaj komunitetit në vitin 2013 si një nga detyrat më paresore të Bashkisë është evidentuar në shifra relativisht të larta të pritjeve dhe komunikimit me qytetarët, ndër të cilat evidentojmë:

- a. Janë dhënë rreth 2775 vërtetime të ndryshme, prej të cilëve 932 për ndihmë ekonomike e shërbime sociale, në funksion të cilësisë së shërbimit dhe në shkurtim të kohës së shërbimit;
- b. Është dhënë asistencë direkte në plotësimin e kërkesave të .....215 qytetarëve, për ndryshim emri, mbiemri, vendbanimi, ndarje e bashkim familjar, etj. shërbime të cilat janë kryer brenda ditës pa krijuar asnjë vonesë tek qytetarët.
- c. Janë asistuar qytetarët në përgatitjen e 100 kërkesave me shkrim, të cilat janë protokolluar dhe ndjekur deri në marrjen e përgjigjeve ligjore nga drejtori, sektori ose zyrat përgjegjëse në bashki.

Por, nëse në shërbimin ndaj qytetarëve, kemi patur arritjen më të madhë në gjashtë vitet e fundit edhe në investimet publike janë bërë ndryshime të dukshme, në krijimin e të ardhurave në dy vitet e fundit kemi patur mangësi të dukshme. Ky është një tregues real, i ndikimit të krizës globale e cila i ka shtrirë efektet e saj si në vendin tonë, përfshirë edhe Bashkinë tonë, ndonëse ky vlerësim dhe tendenca, për të minimizuar ndikimin e kësaj situatë, kanë qenë objekt i punës së çdo punonjësi, e në mënyrë të veçantë i sektorit të financës.

### ***Cila ka qenë përberja e strukturës së administratës dhe cilat ishin disa nga drejtimet kryesore të punës saj, për vitin 2013 :***

Në administratën e bashkisë gjatë vitit 2013 kanë funksionuar 9 drejtori dhe 5 sektorë.

Një administratë prej 67 veta, përfshirë edhe funksionet e deleguara (Gjendja Civile & QKR-ja) dhe 6 institucione vartese me 87 punonjës.

Aktiviteti i vitit 2013 nga punonjësit e administratës dhe institucioneve vartese ka synuar në realizimin e objektivave të parashikuara një vit më parë, pune të cilën do përpiqemi ta evidentojmë sipas drejtorive dhe konkretisht:

## DREJTORIA E TE ARDHURAVE :

### *Ka patur si mision :*

1. Evidentimin e vazhdueshem dhe menaxhimin e subjekteve të tatueshme;
2. Ndjekjën e licencimit të biznesit të vogël e të mesëm në qytet;
3. Perditësimin e database të të gjitha subjekteve tregtare që ushtrojnë aktivitetin e tyre të regjistruara në organet tatimore;
4. Ushtrimin e kontrolleve në rrjetin e biznesit, me objekt realizimin e të ardhurave fiskale, planifikuar për vitin 2013.

### *Cili ka qenë realizimi i detyrave të vitit 2013 nga kjo drejtori :*

Në zbatim të ligjit “Për sistemin e taksave vendore” dhe vendimin e Keshillit Bashkise “Për miratimin e nivelit të taksave e tarifave vendore të vitit 2013” në punën e drejtorisë të “Ardhurave Vendore” ka dominuar tendenca, për një bashkëpunim të vazhdueshëm me komunitetin e biznesit, për realizimin e të ardhurave të buxhetit të planifikuar për vitin buxhetor.

Kështu nga **223.486 mijë lekë** të planifikuara si të ardhura nga taksat & tarifatat për vitin 2013, janë realizuar **99.051 mijë lekë**, ose **44,3 % e planit**.

Ndërsa krahasuar kjo me realizimin në vlerë ndaj një viti më parë (vitit 2012), të ardhurat janë realizuar në masën 95 %.

Realizimi i të ardhurave tatimore dhe jotatimore kanë qenë afërsisht në nivele të përafërta në shifra dhe konkretisht: në masën 43,9 % të ardhurat tatimore dhe 44,9 % jotatimore.

Te renditura sipas emertimit të të ardhurave kemi këto pasqyre:

- a. Te ardhurat nga taksat ishin planifikuar 131.306 mijë leke, realizuar 57.645 mijë leke ose 43,9 %, ndër të cilat evidentojme:
  1. Taksa mbi pasurinë (mbi ndërtesat) planifikuar 15 milion, realizuar 5.974 mijë leke ose 39,8 %;
  2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë planifikuar 70 milion, realizuar 23.489 mijë leke ose 33,3 %;
  3. Taksa mbi biznesin e vogël planifikuar 30.500 mijë leke, realizuar 17.174 mijë leke ose 56,3 %;
  4. Taksa e tabelës planifikuar 4.656 mijë leke, realizuar 1.370 mijë leke ose 29 %.
  5. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësive, planifikuar 10.500 mijë leke, realizuar 9.530 mijë leke ose 90,8 %;
  6. Taksa e zënjes së hapësirave publike planifikuar 500 mijë leke, realizuar 108 mijë leke ose 21,6 %.

Nga kjo pasqyre rezulton se taksat më pak të realizuara dhe më ndikimin më të madh në këto mosrealizime kanë qenë, **taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe ajo e biznesit të vogël**, planifikimi të cilave përben rreth 76,5 % të të ardhurave nga taksat. Ky mosrealizim ka krijuar një defiqit, prej 45,6 % nga totali i të ardhurave të planifikuara.

- b. Ndërsa të ardhurat jo tatimore (tarifat) planifikuar 92.180 mijë leke, janë realizuar në masën 41.406 mijë leke ose 44,9 % ndër të cilat evidentojme:

1. Tarifa e pastrimit nga 25 milion e planifikuar eshte realizuar 10.423 mije leke ose 41,7 %. Tarifa e pastrimit nga biznesi eshte realizuar ne masen 94 %, ndersa ajo e planifikuar nga familjaret eshte realizuar vetem 2,3 %, duke krijuar nje mosrealizim prej 13.867 mije leke.
2. Te ardhurat nga qerate e pronave publike jane realizuar vetem 30 %, duke krijuar nje difiqit prej 2.451 mije leke.
3. Te ardhurat e tjera nga 27 milion leke planifikuar, jane realizuar vetem 16.951 mije leke ose 39,3 %.

Mosrealizimi të ardhurave nga taksat dhe tarifatat e vitit 2013 kane patur aresye objective dhe subjective, nder te cilat evidentojme:

Si aresye objective mund te evidentojme faktin:

- Mungesa e Planit Pergjithshem Rregullues, krijoj nje bllokim te plote te ndertimeve ne qytet. Si rrjedhoje nuk u realizuan te ardhurat e planifikuara nga ndikimi ne infrastrukture, takse e cila ze 31,3 % ne totalin e te ardhurave nga taksat ose 31 % te te ardhurave te pergjithshme te planifikuara per vitin 2013.
- Mbyllja ose pezullimi i aktivitetit per 91 subjekte dhe kalimi ne regjistrin pasiv te 57 subjekteve te tjera ndikuan ne mosrealizimin e te ardhurave nga biznesi i vogel.

Ndersa mosrealizimet e tjera jane kryesisht per aresye subjektive nder te cilet evidentojme:

- Mosrealizimi i takses nga biznesi vogel ne masen 13.326 mije leke ose 43,7 % te planit, duhej minimizuar, nepermes nje pune me intensive ndaj subjekteve debitore;
- Taksa e tabelës eshte realizuar vetem 29 % duke krijuar nje difiqit te pajustificuar, prej 3.286 mije leke etj.

Keto mosrealizimi ne teresine e tyre kane krijuar veshtiresi ne pagesat ndaj shpenzimeve, investimeve ne infrastrukture dhe sipermarrjeve te sherbimeve.

Kemi bindjen se, me nje pune me te organizuar dhe nje kerkese me te larte pergjegjesie nga stafi drejtorise perkatese, do kishin nje nivel tjeter realizimi. Kete e tregoj edhe fakti se vetem nga nje organizim i punes se drejtorise te ardhurave me policine bashkiake ne fundin e vitit 2013, qe u bllokuan llogari bankare te bizneseve debitore u mblodhen 5,7 milion leke. Vlen te theksohet fakti se angazhimi ne pune, serioziteti ne kryerjen e detyres dhe kompetenca profesionale e punonjesve te drejtorise tatim taksave ka lene mjaft per te deshriuar. Keto mangesi mund te kene edhe aresye objective, te lidhura me formimin profesional, apo pervojen ne pune te ketij stafi, por gjithsesi jane te pajustificueshme. Ndaj kerkojme qe ky staf te vihet ne nivelin e kerkesave te detyres, duke nxjerre pegjegjesite e percaktuar detyrat, per vitin 2014 qe kemi filluar.

## **DREJTORIA E FINANCES :**

### **Kjo drejtori ka synuar :**

1. Ne ndjekjen vazhdueshme te gjendjes financiare dhe ushtrimin e kompetencave te saj, per rritjen e efektivitetit ekonomik dhe financiar.
2. ne zbatimin e nje politike financiare me objekt, per te ruajtur te balancuar te ardhurat me shpenzimet administrative.

3. ndjekjen ne menyre permanente te situates ekonomike dhe prezantimin e nevojave, per ndryshime te mundeshme ne buxhetin e vitit, per te ruajtur ekuilibrat financiare etj.

### **Por, cilët kane qene disa nga treguesit financiar të vitit 2013 :**

Ne buxhetin e vitit 2013 siç theksuam edhe me siper, kane qene planifikuar te ardhura nga taksat, tarifat dhe aktiviteti ekonomik i Bashkise **223.486 leke**, ndersa realizimi ka qene **99.051 mije** leke ose 44,3 % e planit;

- **Fondi i pagave** - planifikuar 56.114 mije leke, realizuar 54.164 mije leke ose 96,5 %.
- **Shpenzime operative** - planifikuar 54.309 mije lekë; realizuar 22.786 mije leke ose 41,9 %.
- **Investimet** - planifikuar 98.628 mije leke; realizuar 28.850 mije leke ose 29,2 %.
- **Sherbime te kontraktuara** - planifikuar 35.785 mije leke; i pritshmi 24.501 mije leke ose 68,4 %.
- **Shpenzimet buxhetore** ne total, per vitin 2013, u realizuan ne masen 58.017.981 leke ndaj 114.221 mije leke te planifikuara ose 50,7 %.

Viti 2013, ishte nje vit i veshtire nga ana financiare, jo vetem se ishte vit elektoral, por sepse kriza ekonomike globale ka ndikuar ndjeshem ne te ardhurat e biznesit dhe qytetareve, ndikime te cilet reflektovan negativisht ne realizimin e buxhetit te Bashkise.

Ne te ardhurat e vitit te kaluar ka patur ndikimet e veta edhe shkurtimi grandit te vitit 2013 nga Qeveria, ne masen 10 milion leke.

Keto aresye jane reflektuar ne uljen e aftesise paguse te bashkise si, tek faturat e mallrave, sherbimeve dhe investimeve te reja.

Ndonese mosrealizimi te ardhurave ka ndikuar negativisht ne financimin e sherbimeve dhe investimeve, nje kujdes i vecante eshte treguar ne mbajtjen nen kontroll te shpenzimeve, per te balancuar nivelin e te ardhurave e shpenzimet.

Nese ne gjithë keto paragrafe, trajtohen mosrealizime ne te ardhurat e vitit 2013, puna e drejtorise se finances, ka vleresimin e saj. Kjo e lidhur me punen gjithëvjete qe ben stafi i kesaj drejtores, si ne disiplinën administrative shembullore dhe ne ndjekje te perditeshme te gjendjes financiare dhe zbatimin e nje regjimi te forte kursimi ne te gjitha aspektet.

Keto dite kjo drejtori eshte ne fazen e hartimit te buxhetit, miratimi i te cilit do behet pas miratimit qe keshilli Bashkise i bëri paketes fiskale dhe struktures se administrates.

Ne kete faze nga kjo drejtori duhet treguar kujdes si ne hartimin e buxhetit dhe ndjekjen e realizimit te treguesve financiare, per te mbyllur deficitet e trashegura e per te garantuar progresin e vitit 2014.

Sjellin nder mend faktin se objektivat e vitit 2014 jane mjaft ambicioz, ndaj kerkohet seriozitet nga i gjithë stafi, si per ata qe planifikojne, ata qe grumbullojne te ardhura dhe ata qe i shpenzojne.

### **DREJTORIA PLANIFIKIMIT TERRITORIT:**

#### **Ka patur si objektiv :**

1. Zbatimin e ligjislacionit ne planifikimin e territorit, ne administrimin e qytetit, si ne

- aspektin e ndertimeve te reja dhe rikonstruksionet ne objekte publike e private.
2. Realizimin e strategjise se zhvillimit urban dhe menaxhimin e territorit të qytetit,
  3. Hartimin e projekteve te zhvillimit, ne infrastrukturen publike dhe ndjekjen e realizimit te investimeve ne te gjitha fazat, deri te realizimi perfundimtar i tyre,
  4. Mbajtja ne standarte te larta, te komunikimit me publikun, vleresimi i problemeve dhe ndjekja e tyre, qe nga zyra me nje ndalese, deri ne zgjidhjen profesionale te kerkesave.
  5. Ne kryerjen e detyrimeve ndaj investitoreve privat si ne aspektin e dhenien e ndihmes teknike edhe mbledhjen e dokumentacionit per ti kaluar per miratim.
  6. Në plotesimin e dokumentacionit per regjistrim te pronave që me v.k.m nr 414,& 1686 te viteve 2007 & 2008.
  7. Mbajtja e korespondences zyrtare me institucionet, si kusht i nevojshme per t'i dhene zgjidhje te shpejte problemeve ne pergjithsi.
  8. Dhenjen e zgjidhjes afatshkurter per miratimin e Rregullores Tip te Planifikimit deri ne hartimin e Planit Pergjithshem Rregullues, per te mundesuar zhvillimin urban te qytetit.

#### **Nder detyrat funksionale te kesaj drejtorie per vitin 2013 evidentojme :**

- Jane organizuar e ndare pergjegjesite sipas sektoreve nga stafi i drejtorise dhe jane ndjekur detyrat ligjore e teknike nga secili specialist:
- Eshte ndjekur puna e investimeve publike, me te gjitha problematikat si cilesia, menaxhimi i problemeve lidhur me financimet, shpronesimet, konsultime te vazhdueshme me komunitetin. etj.
- Jane ushtruar dhe mbajtur akte - kontrolli per te gjitha objektet (e pajisura me leje ndertimi) qe jane ne ndertim e siper, sipas fazave te ndertimit.
- Jane dhene lejet e shfrytëzimit për objektet jane shqyrtuar vetëm pasi janë plotësuar detyrimet sipas studimeve urbanistike pjesore dhe ligjit te Planifikimit Territorit..
- Eshte shqyrtuar e arshivuar dokumentacioni teknik e juridik i kerkesave te reja per sheshe e leje ndertimi.
- Jane hartuar projekte nga me te voglat deri ato strategjike, per investimet ne infrastrukture dhe jane ndjekur investimet publike te vitit 2013 ne territorin e Bashkise, nder te cilet evidentojme:
  - Rikonstruksioni rruges lage “nene Tereza” - Faza I & II.
  - Sistemim Blloku 11.2 ha.
  - Sistemimii lagjes së bregut të Drinit blloku A.
  - Rikonstruksion i shkolles profesionale “Kolin Gjoka”
  - Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare “Gjergj Fishta”
  - Rikonstruksion i rruges se Spitalit.
  - Rikonstruksion i Ures se vjeter.
  - Sistemim i bllokut Lagje Gurra.
  - Sistemim i bllokut pas shtepise se ish ushtarakeve.
  - Rikonstruksioni rruge Ing. Gj. Gjadri.

### Sektori projektimit e planifikimit territorit:

- Ka ndjekur korrespondencen zyrtare dhe kthimin e pergjigjeve, per shkresat e ardhura, nga qytetare.
- Jane pranuar kerkesat e ankesat ne zyren me nje ndalese
- Jane pergatitur dhe publikuar listat dhe gjithë dokumentet ligjore dhe teknike, qe duhen plotesuar per te aplikuar per leje te ndryshme prane Drejtorise se Planifikimit te Territorit, ne programin e “Sistemit per Kerkeat dhe Ankesat” te Zyres me Nje Ndalese
- Jane hartuar projekt-ide dhe pajisur me preventiva perkatese per objektet:
  - Shtese ne tregun egzistues te qytetit
  - Treg i ri ne lagjen “Skenderbeg” ne veri te Memorialit “Skenderbeut”.
- Në kuadrin e hartimit të projekteve të zhvillimit të qytetit të Lezhës, eshte bere verifikimi ne terren dhe eshte hartuar relacioni per sistemimin e lagjes “Gurra”
- Eshte pergatitur materiali me foto, planvendosja per vendosjen e dy busteve te vellezerve Coku ne lulishten e qytetit

Sektori i **Kadastres Urbane** (*asetet*) gjate vitit 2013 e ka përqëndruar punën kryesisht në plotesimin e dokumentacionit per te mundesuar regjistrimin e pronave, proces i cili deri tani ka arritur ne 280 numrin total. Gjithashtu ka pergatitur dokumentacionin per 70 astete te tjera.

Per vazhdimin e punes ne kete sektor duhet planifikuar ne buxhetin e vitit 2014 nje fond i veçante, per procedurat e regjistrimit ne ZVRRPP-se.

### ***Nder problemet e vitit 2013 evidentojme:***

Duhet vleresuar fakti se hapesira ligjore per ndertime te reja gjate vitit 2013 ka qene teje e kufizuar deri ne muajt e fundit kur u miratua Rregullorja Tip e Zhvillimit te Territorit. Kjo ishte nje aresye ligjore qe bllokoj, per dy vite radhazi mundesine e dhenjes se lejeve te zhvillimit, gjithashtu duhet pranuar fakti se hapesirat e trojeve ne qytetin tone nga viti ne vit ka ardhur duke u zvogeluar. Ndaj edhe te ardhurat nga ky sektor mbeten mjaft te kufizuara.

Ndersa ne vitin 2014 e vijim, aspekt i rendesishem ne punen e kesaj drejtorie mbetet partneriteti me investitorët privat, krijimin e hapesirave ligjore, per paraqitjen e dokumentacionit teknik per objekte te reja ose rikonstruksione e dhenja e pergjigjeve ne afatin qe percakton ligjit Nr. 10119 datë 23.4.2009 “Per Planifikimin e Territorit”.

## **DREJTORIA E NDIHMES EKONOMIKE & PERKUJDESIT SHOQEROR**

### **Ka patur si objektiv :**

1. Evidentimin e familjeve ne nevojë dhe personave me aftësi të kufizuar; brenda territorit të bashkisë, per t'i ofruar ndihmën e nevojshme ekonomike e shërbimin e duhur social brenda kuadrin ligjor.
2. Bashkëpunimin me sektore homolog dhe OJF, për hartimin e programeve te përbashketa ne ndihme te familjeve ne nevoje dhe personave vunerabel. ??



3. Hartimin e projekteve publike me veprim afatshkurter & afatmesëm, për zbutjen e varfërisë, barazine gjinore, mbrojtjen e grave te dhunuara dhe integrimin e pakicave mbeshtetur ne Strategjine Kombëtare.

Gjate vitit 2013 ne kete drejtori kane funksionuar dy sektore si :

- a. Sektori i Ndhimes Ekonomike &
- b. Sektori Sherbimit Shoqeror dhe barazise Gjinore.

Per **sektori i ndihmes ekonomike**, detyra kryesore ka qene ruajtja e skemes se ndihmes ekonomike ne mbeshtetje te ligjit, pa cenuar perfshirjen e familjeve te reja, ose pastrimin e skemes nga familje dhe persona qe nuk kane mbeshtetje ligjore, per t'u trajtuar me ndihme ekonomike.

Keshtu mund te evidentojme faktin se ne vitin 2013 kemi patur mesatarisht:

- a. Rreth **549 familje** te perfshire ne skemen e ndihmes ekonomike;
- b. Jane pranuar me shume 45 familje te reja.

Nga bashkëpunimi me instiucionet detyruese ne zbatim te akteve nenligjore cdo muaj janë larguar familje nga skema e ndihmës ekonomike, per shkaqe të aresyeshme si punësim, me pjesëtar familje në emigracion, mosplotësim dokumentacioni etj.

Gjate vitit 2013, per sektorin e ndihmes ekonomike eshte shperndare nje fond prej 4.459.292 leke,

Numri familjeve te trajtuara me ndihme ekonomike nga viti 2010 ka patur nje ritmike te qendrueshme si:

Numri i familjeve	Vitet			
	2010	2011	2012	2013
	546	554	546	549

Ndersa **Sektori i Perkujdesjes Shoqerore** ka patur si objekt pune :

- Hartimin rregullisht te grafikut kontrollit te dosjeve;
- Plotesimi i dosjeve me dokumentacionin e nevojshem;
- Evidentimin e subjekteve qe perfitojne ligjerisht perkrahje sociale per paaftesine shendetesore dhe perkusje shoqerore.
- Menaxhimin e fondit akorduar per kete kategori shoqerore;
- Bashkepunimin me institucionet e specializuara qe kane kompetencen, per vleresimin e kesaj kategorie.
- Pergatitja e listpagesave e dhenja ne kohe e pageses akorduar nga Min. Punes & Çeshtjeve Sociale.
- Ndjekjen e problemeve sociale qe kane te bejne me dhunen ne familje, barazine gjinore, te drejtat e komuniteteve, femijeve etj.

Te dhenat e numrit te personave te trajtuar gjate vitit 2013 te krahasuar nder vite jane sipas tabelës :

Emertimi	Te trajtuar sipas viteve			
	2010	2011	2012	2013
Persona te trajtuar	<b>742</b>	<b>788</b>	<b>837</b>	<b>886</b>

Ketij numri prej 886 veta u shtohen edhe 114 kujdestaret e tyre, per te cilet eshte akorduar nje fond prej **89.330.500 leke**. per vitin 2013.

• ***Krahasuar nder vite këmi këto të dhena:***

	Vitet			
	2010	2011	2012	2013
<i>Fondi akorduar 000/ lek</i>	<i>640.514</i>	<i>75 233</i>	<i>82 750</i>	<i>88.589</i>

Aspekt i rendesishem i punes se kesaj drejtorie per vitin 2013 ka qene sektori “Barazise Gjinore” i cili mori nismen nga nje projekt i fituar nga Bashkia, per te vijuar me tej si nje sektor mjaft i nevojshem per kohen dhe problematiken sociale qe kalojme. Kete sektor e presim pergjegjesi te reja, jo vetem per emertimin qe ka, por edhe problematiken sociale qe ndjek ne gjithe veprimatrine e tij. Ky sektor kete vit do mbuloje problemet sociale me evidente te sotme, si barazine gjinore, dhunen ne familje, komunitetet ne nevoje, te drejtat e femijeve etj. Ndaj analiza e punes se ketij sektori do jete me e plote ne fundin e ketij viti.

*Nder problemet e evidentuara ne kete sektor per vitin 2013 theksojme:*

1. Kerkesa dhe tendenca e mjaft banoreve qe te perfshihen ne skemen e ndihmes ekonomike, ndonese nuk permbushin kriteret ligjore.
2. Mungesa e fondeve akorduar nga Ministria Punes, soli shqetesime ne likuidimin e ndihmnes ekonomike dhe paaftesise ne fundviten 2013.

**DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE:**

Nje nga drejtorite me evidente, per komunitetin dhe vete Bashkine, per faktin se kjo drejtori mbulon aspekte mjaft te prekshme per cdo banor. Qe puna e saj eshte pasqyre e drejtimit, sherbimit dhe kultures qe pret komuniteti. E lidhur kjo me sektoret mjaft te rendesishem qe mbulon.

**Si e tille per vitin 2013 ka patur si objektiva kryesore :**

1. Rritjen e cilesise se sherbimit ndaj qytetareve, per pastrimin dhe menaxhimin e mbetjeve urbane;
2. Ruajtjen dhe shtimin e fondit të gjelbërt në qytet dhe kurorën përreth tij, për te patur një qytet të pastër me gjelbërim gjithëvjetor;
3. Bashkëpunim dhe partneritet me komunitetin qytetar, per te misheruar kerkesat tona me pritmerite e qytetareve, per nje qytet me vlere kulturore dhe turistike.
4. Nje staf i monitoruar nga komuniteti, ne cdo moment ne punen e perditeshme dhe gjate implementimit të projekteve ambicioze qe kemi ndermarre.
5. Ndjekjen ne menyre permanente mirëmbajtjen e institucionet publike, rrjetin rrugor, sistemin e kanalizimeve, sinjalistikën, rrjetin e ndriçimit publik etj.;

***Realizimi i pergjegjesive nga kjo drejtori:***

Kjo drejtori edhe gjate vitit 2013 eshte vleresuar si nje nga drejtorite e rendesishme, jo vetem per faktin se administron gjithe asetet publike ne qytet, por qe eshte konsumatorja

kryesore e te ardhurave te Bashkise. Sektoret kryesor te kesaj drejtorie jane sipermarrije private si pastrimi, gjelberimi, dekori dhe shergbimi varrimit.

Te analizuar ne vecanti kemi kete problematike:

a. **Spektori i pastrimit:** si me i prekshem nga komuniteti, ka patur si objekt mbajtjen e qytetit te paster, larjen e rrugëve dhe menaxhimin e mbetjeve urbane. Ky sektor mbulon hserbimin e pastrimit ne te gjitha rruget, sheshet dhe trotuaret e qytetit, ne 80 pika grumbullimi me rreth 170 konteiner.

Projekti i mirenjohur, per grumbullimin dhe menagjimin ne menyre te diferencuar te mbetjeve urbane ka bere te mundur qe ky sherbim jo vetem te kete rritje por tani mund te flasim per standart sherbimi ne zonen ku eshte i shtrire ky projekt .

Gjate ketij viti ne funksion te ketij projekti nga Bashkia ne bashkepunim me URI ka shtrire sistemin e grumbullimit te mbetjeve ne menyre te diferencuar ne gjithe zonen A te sherbimit ku sot kemi rreth 40 pika te tilla .

Vec kesaj ne funksion te sensibilizimit per ndarjen e mbetjeve ne burim ne te gjitha objektet shkollore te qytetit dhe disa institucione jane shperndare kosha te vegjel 120 L me etiketat perkatese per mbetjet e riciklueshme dhe te pariciklueshme.

Rritja e cilesise se sherbimit te grumbullimit te mbetjeve urbane ne menyre te diferencuar eshte mundesuar, duke paraqitur nje sistem te ri grumbullimi, nga sistemi me 4 rryma ne sistemin me 2 rryma gje e cila ka lehtesuar, mbledhjen dhe ndarjen e mbetjeve urbane. Ndersa performanca e ketij sherbimi eshte rritur nga zevendesimi i konteinerëve te demtuar me konteiner te rinje dhe vendosja e koshave te vegjel ne rruget kryesore te qytetit.

Por, ndonese ne kete sektor ka nje tradite dhe pervoje mjaft te mire fituar ne vite, duhet pranuar fakti se gjate vitit 2013 ky sektor ka patur edhe probleme.

Jo rralle here kemi patur mangesi ne drejtim te cilesise se ketij sherbimi ne gjithe teritorin qe mbulohet nga kompania e pastrimit me pretendimin e saj, per veshtiresite financiare qe ndeshen per shkak te mospageses se kontrates nga Bashkia.

Per te zbutur kontradikten me kompanine e pastrimit jemi detyruar te zvoglojme harten e pastrimit ne rreth 40 %, duke shmangur disa zona ne perifei, ose ndonje rruge jo problematike.

Gjithashtu jemi detyruar te rrisim bashkepunimin e kompanise me sektorin e sherbimeve, per te mbuluar ate mangesi qe krijonte kompania, gje e cila mundesoj nje permiresim te ndjeshem muajt e fundit te vitit duke rritur nivelin e cilesine se ketij sherbimi.

Mjaft i rendesishem eshte konsideruar **sektori i gjelberimit.**

Per nje qytet historik, me trashegimi kulturore, ne nje qytet bregdetar si Lezha, jane te gjitha kushtet klimatike dhe tradita ne dekada, per te patur nje qytet gjithëvjeter te gjelberuar, me bimesi bregdetare te natyres mesdhetare. Ky fakt ka dominuar ne konceptimin e detyres nga sipermarrija e gjelberimit, qe te mirembaje e permiresoje bimesine e dekorative kryesisht drurore, per te kombinuar raportet bimesise gjethe renëse si bliri e rrapi, me ata me gjelberim gjithëvjeter si Palma, Pisha, Bredhi, Magnolja etj. Ky sherbim realizohet nga shoqeria “Floral” e cila ka nje pervoje te gjate ne sherbimin e gjelbrimit.

Sherbimi kryhet ne nje siperfaqe prej 90.561 m2, si ne siperfaqet e barit natyral, barit te kultivuar (lulishteve), gjithe bimesise dekorative drure dhe shkurre qe ndodhen ne teritorin e qytetit

Krahasuar me vitin 2008 (me 76668 m<sup>2</sup>), kemi rreth 15000 m<sup>2</sup> ose 15% me shume siperfaqe te gjelberta si rezultat i kthimit te disa siperfaqeve inerte ne siperfaqe te gjelberta dhe perfshirjes se hapësirave te gjelberta te shkollave ne qytet ne mirembajtje.

Gjate vitit 2013 drejtoria e sherbimeve ne bashkepunim me siper marrjen i kane kushtuar nje rendesi te vecante rritjes se cilesise se sherbimeve ne siperfaqet e gjelberta dhe perdorimit te teknikave te reja ne dhenin e formave te gardheve te gjelberta, te drureve e shkurreve dekorative duke ndikuar ne rritjen e performances se ketij sektori.

Nje nder problemet shqetesuese gjate kesaj periudhe ka qene mos funksionimi i sistemit te vaditjes, i cili ka patur pasoja jo te pakta gjate periudhes se veres.

Theksojme faktin se veshtiresite financiare kane ndikuar edhe ne kete sektor, jo vetem ne kryerjen e detyrimit ndaj shoqerise dhe efektivitet te punetoreve te saj, por jemi detyruar te reflektojme ne zvoglimin e hartes se sherbimit, kryesisht ne zonen e periferise qytetit.

**Dekori** qytetit eshte siper marrje e shoqerise "Floral", I cili per hir te tradites ka mundesuar plotesimin e kerkesave te kontraktuara. Kjo eshte verejtur ne krijimin e mjedisve festive ne festat zyrtare dhe fetare. Por vlen te theksohet kerkesa, per nje riformatim teresor te dekorit te qytetit. Ky sektor duhet projektuar dhe realizuar ne harmoni me objektivat primare qe ka Bashkia, ate te kthimit te plote te qytetit ne funksion te turizmit kulturor gjithëvetor.

Ky objektivi mbetet per muajit ne vijim, mbase edhe kete vit mund dhe duhet t'i paraprijme me projektin e permiresimit teresor te dekorit.

**Sherbimi Varrimit**, eshte kryer me seriozitet dhe ne harmoni me kerkesat e komunitetit. Varrezat publike dhe ato te Deshmorëve, mirembahen ne praktiken gjithëvetore. Por shqetesimi I siperfaqes se kufizuar, per varrezat publike mbette nje shqetesim I cili duhet mbajtur ne qender te vemendjes, per te bashkerenduar me Ministrine e Brendshme, per te finacuar blerjen e siperfaqev et reja te ketij sherbimi.

Objektivat e permiresimit te punes ne siper marrjet e sherbimeve publike do vleresohen si nder objektivat kryesore te punes se administrates bashkise per vitin 2014.

Krahas sektoreve me siper marrje, kjo drejtori ka ne perberjen e saj edhe tre sektor qe administrohen nga stafi i saj, si :

- a. Sektori sherbimit veterinar dhe mbrojtjes se konsumatorit.
- b. Sektori i mjedisit, emergjencave, strehimit & transportit;
- c. Sektori i mirembajtjes se infrastruktures dhe institucioneve.

Meqenese I kemi kushtuar nje vemendje te vecante sektoreve te sherbimit, me siper marrje, per vete rendesine qe ata kane, sektoret e tjere do perpiqemi t'i trajtojme ne vija te pergjithshme dhe konkretisht:

a. **Sektori sherbimit veterinar dhe mbrojtjes se konsumatorit;** nje sektor me pervoje shume vjecare dhe nje tradite mjaft te mire, me nje emertim te ri sherbimi, atij te "Mbrojtjes se Konsumatorit" me nje moshe vetem 1 vjecare.

Tre punonjesit e ketij sektori kane ushtruar kontrole te perditeshme, te vetem ose ne bashkepunim me Policine Bashkiake dhe institucione te tjera si AKU dhe DSH Publik.

Ndonese me kundershti e here here me veshtiresite qe sjell tregu dhe subjektet private te tregetimit te produkteve shtazore, te peshkut dhe ushqimore, duhet pranuar fakti se ky sector eshte vene ne baza ligjore dhe rregullsi praktike.

b. **Spektori i mjedisit strehimit dhe emergjencave civile;** ndonese i perbere vetem nga nje punonjes, ka patur si object mbajtjen nen kontroll te situates mjedisore ne qytet. Ky sector ka qene bashkepunetor dhe oponent I siper marrjeve dhe qytetareve qe shkelin normat e bashkejeteses komunitare, ne aspektin e ruajtjes dhe mirembajtjes se situates mjedisore.

Eshte bashepunuar me ARM dhe Nd. Ujesjelles – Kanalizimeve, per zgjidhjen e problemeve te komunitetit dhe ato mjedisore.

Ne sherbim te banoreve te pastrehe, jane pranuar dokumentat dhe paraqitur ne Keshillin e Bashkise te gjitha ata qe plotesojne kushtet ligjore, per tu trajtuar si te pastrehe, e deri ne muajt e fundit, per trajtimin me kredi per banese.

c. **Spektori i sherbimeve ne infrastrukture dhe institucione,** ka qene ne funksion te mirembajtjes se infrastructures dhe institucioneve publike ne qytet.

E rendesishme eshte te theksojme se jane kryer te gjitha sherbimet e parashikuara ne institucione t e arsimit ne qytet, per te mundesuar zhvillimin ne kushte normale te mesimit ne shkollat e qytetit. Gjithashtu eshte nderhyre me riparime e rikonstruksione pothuajse ne te gjitha objektet e institucioneve ne varesi te Bashkise.

Krahas punes per mirembajtjen e institucioneve, nga ky sector eshte punuar per mirembajtjen e sistemit te kanalizimeve te ujrave te bardha , mirembajtjen e rrugeve te pa asfaltuara, riparimin e trotuareve, heqje inertesh etj.

Vemendje te vecante eshte kushtuar mirembajtjes se sistemit te ndricimit ne te gjitha mjediste e qytetit dhe institucione.

Por, vlen te permendet fakti se ky sector nuk e ka permbush shtrirjen gjithe vjetor me ngarkese pune, per sa punonjes ka sektori. Ky fakt vjen, sepse nuk ka qene e mundur te paiset me bazen material, pa shmangur edhe indisciplinin e disa punetoreve te ketij sektori.

Kjo ishte edhe arsya qe u mendu per kalimin me siper marrje sherbimi I mirembajtjes se institucioneve dhe infrastructures publike.

Per vitin qe sapo kemi filluar, qe ky sector te mbijetoje me kete kontigjent punetoresh, duhet te perfshihet ne shume aspekte pune, te sherbimit komunal ne qytet.

## **DREJTORIA JURIDIKE & PROKURIMEVE PUBLIKE :**

### **Ka patur si detyre :**

1. Të jape asistencen juridike, ne gjithe veprimtarinë e administrates Bashkise;
2. Te asistojte hartimin e akteve administrative qe dergohen per miratim tek Kryetari i Bashkise dhe Keshillin Bashkiak;
3. Te ndikojte ne trajnimin juridik te personelit;
4. Te përfaqësoje institucionin e Bashkise, në procese gjyqësore, për të gjitha shkallët e gjykimit, si te paditur ose pale e interesuar;
5. Realizimin e prokurimeve publike, mirembajtjen e dokumentacionit dhe lidhjen e kontratave me sipermarresit.

### ***Si jane realizuar detyrat e ketij sektori:***

- Ne harkun e 12 muajve te vitit 2013, nga drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike, jane ndjekur 17 çeshtje gjyqesore nga te cilat 14 ne Gjykatener Shkalles pare Lezhe dhe Apelit Shkoder, ndersa 4 çeshtje jane ndjekur ne Gjykaten e Rrethit Tirane.
- Sektori Juridik ka asistuar 110 akte administrative (urdhera & vendime) te konfirmuara nga Kryetari i Bashkise, 63 urdhera Prokurimi dhe 93 akte te miratuara nga Keshilli Bashkiak.
- Nga sektori i Prokurimeve Publike jane zhvilluar 18 tendera per mallra, sherbime, investime publike dhe jane hartuar kontrata dhe amendime te nevojshme per zgajtjen e afateve per tenderat e zhviluar, per vitin 2013 3 fillimvitin 2014.
- Eshte dhene ne te gjitha rastet e nevojshme konsulenca juridike drejtorive, si për njohjen e legjislacionit dhe interpretimin e ligjit per rastet konkrete.
- Jane pergatitur praktikat e nevojshme, per fillimin e procedurave te privatizimit, per objektet e kerkuara dhe legalizimin e banesave te ndertuara para vitit '93.

### ***Disa probleme te evidentuara ne kete drejtori:***

1. Me gjithë argumentat e paraqitura nga perfaqesueset e kesaj drejtorie ne seancat gjyqesore, ne pjesen me te madhe Bashkia ka dale e humbur ne gjyqe.
2. Jo gjithmone ka qene ne nivelin e kerkuar bashkerendimi dhe pergatitja e duhur nga specialistet tane qe kane perfaqeuar Bashkine ne seanca gjyqesore;

## **DREJTORIA E PROGRAMIM ZHVILLIMIT :**

### **Ka patur si objektiv te vitit 2011:**

1. Bashkepunimi me drejtorite dhe institucionet vartese, pe evidentimin dhe perpunimin e indikatorëve te zhvillimit social-ekonomik, per hartimin e Strategjise Zhvillimit;
2. Bashkëpunimin me donator vendase e të huaja, fondacione dhe shoqata, te cilat shprehin interes, per te bashkepunuar ose investuar ne territorin e Bashkise;
3. Harmonizimi i strategjise se zhvillimit te qytetit tone me strategjite e zhvillimit rajonal e kombetare, ne perputhje me standartet europiane.
4. Pergatitja dhe afishimi i materialeve promocionale, ne te cilat pasqyrohet puna dhe aktiviteti gjithëvjeter i Bashkise;
5. Azhornimi i faqes se internetit dhe mirembajtja e logjistikës elektronike te aparatit;
6. Te monitoroje realizimin e detyrave per implementimin e projekteve dhe strategjive te zhvillimit.
7. Ndjekjen e ecurise se projekteve ne infrastrukture, me financime nga donator vendas apo te huaj.

### **Nder realizimet e vitit 2013 evidentojme:**

- Eshte finalizuar vizioni, qellimet dhe objektivat e Strategjise se Zhvillimit.

- Eshte avancuar me fishat e projekteve per strategjine e re
- Jane percaktuar indikatorët mates per tu perfshire ne strategji;
- Eshte miratuar ne Keshillin e Bashkise platforma permbledhese e Strategjise se re
- Eshte finalizuar Plani i Veprimit lokal per Romet,
- Eshte miratuar Plani Strategjik 2014-2016 per Trajtimin dhe Parandalimin e Korrupsionit ne Bashki;
- Jane selektuar projektet prioritare, per vitin 2014 ne Strategjine e Zhvillimit te Qendrueshem

***Nder projektet ekonomike dhe sociale te financuara ose ne proces evidentojme:***

- Ndertimin e murit rrethues ne kompleksin e shkollave ne lagje Beselidhja.
- Sistemimi infrastruktures lagje Skenderbeg, e banuar ne mase nga komuniteti i Romeve dhe Egjyptjaneve;
- Implementimi i projektit te IPA per Turizmin, (*konkretizuar me realizimin e tabelave treguese; Broshura; Fletpalosje informative turistike; analize oferte turistike; harta turistike*); krijimi i itinerareve te perbashketa ne rajonin e Adriatikut bazuar ne turizmin kulturor;
- Per nje periudhe nje vjeçare u zbatu projekti integrimin gjinor dhe po punohet per planin e veprimit;
- Praktika me te “Mira per Integrimin e Romeve” eshte projekti i cili ka permiresuar raportet e bashkise me komunitetin Rom dhe Egjyptian;
- Trajtimi dhe Parandalimi i Korrupsionit duke rritur kapacitet e stafit te Bashkise
- Partneritet Drejtorine e Sherbimeve Publike me Projektin URI-t ka futur ne nje faze te re nismen e menaxhimit te diferencuar te mbetjeve urbane;
- Projekti per Panelet Diellore (UNDP)
- One Stop Shop (DLDP),
- Projekt Ide per ndricimin me LED etj.

Keto projekte jo vetem kane plotesuar nevojën per disa financime te munguara si ne aspektin sociale dhe infrastrukturen publike, por kane krijuar nje partenrite te ri me praktikantët e BE-se dhe donatoreve te ndryshem europian, si faze per gatitore, per t’u integruar ne strukturat e BE-se.

***Cilat jane disa nga arritjet e evidentuara:***

1. Eshte permiresuar puna kordinuese me drejtorite ne hartimin, zbatimin dhe monitorim te politikave te zhvillimit.
2. Eshte raportuar ne kohe dhe sipas standarteve tek donatore e projekteve te financuara prej tyre (*Ku jemi vlersuar me certifikate mirenjohje per motivim dhe perkushtim profesional*)
3. Jane perkthyer ne projekte politikantët e reja, trendet ne sfidat e zhvillimit si Integrimi Gjinor dhe Integrimi me i mire i Romeve
4. Eshte ndikuar ndjeshem ne rritjen e performances se stafit te bashkise Lezhe ne nivel lokal dhe me gjere;

5. Ne prezantimin me dinjitet Bashkiane Lezhe edhe ne shkalle vendi, para intitucioneve te ndryshme dhe partnereve te huaj. (*nepermes panairë, botime, websiti, takime etj*)

***Disa probleme te evidentuar ne punen e kesaj drejtorie:***

1. Mbledhja e te dhenave nga drejtorite dhe sektoret ne Bashki, per statistiken dhe strategjine e zhvillimit ka marre shume kohe nga puna e kesaj drejtorie. Kjo ka ngadalesuar punen per perfundimin e strategjise dhe ka ndikuar ne efektivitetin e punes saj.
2. Vesh tiresi jane verejtur ne perfshirjen e komunitetit ne politikëberjen e Bashkise;

***Çfare mund te ishtes bëre me mire:***

1. Puna per lidhjen me donatoret potenciale duhet intensifikuar per tu shtuar numrin e projekteve ne zbatim.
2. Puna per mbledhjen e statistikave mbetet akoma sfide per tu permiresuar ne vitin 2014.

**DREJTORIA E ARSIMIT, TURIZMIT, KULTURES & SPORTEVE**

**Ka patur si objektiv :**

1. Të sigurojë raporte partneriteti dhe marrëdhënie efektive me gjithë faktorët bashkëpunues per krijimin e kushteve optimale, ne zhvillimin e procesit mesimor, faktor kryesor për ngritjen e cilësisë në sektorin e arsimit;
2. Ngritjen ne nivele te veprimtrive kulturor e sportive dhe bashkëpunimi me grupet e interesit dhe komunitetin e biznesit, në funksion të rritjes se cilësisë dhe implementimit të projekteve të zhvillimit ne keto sektorë;
3. Koordinimin e punës me institucione perkatese, per nje pune shkencore permanente ne evidentimin dhe propogandimin e vlerave historike e arkeologjike të zbuluara ne funksion te zhvillimit te turizmit kulturor.

**Cili ka qene niveli i realizimit detyrave:**

Gjate vitit 2013 stafi i kesaj drejtorie, ne vijim te pervojës se fituar, ka bëre perpjekje per zgjedhjen e detyrave funksionale, per harmonizimin e sektoreve te arsimit dhe kultures, si per mbarevajtjen e punes ne shkolla dhe per te patur nje jete kulturore gjithvjetore ne funksion te komunitetit.

Nder angazhimet kryesore mund te evidentojme :

**Ne sektorin e arsimit** ka patur nje vleresim maksimal, mirembajtja e shkollave dhe plotesimin e nevojave imediate, per te mundesuar zhvillimin normal te procesit mesimor.

Aktualisht ne qytetin tone kemi per arsimin 9-vjeçar 5 shkolla publike dhe 2 jopublike, 2 shkolla te mesme publike dhe 2 jopublike, ne te cilat frekuentojne 5698 nxenes te cilet perbejne 19,5 % te popullsisë se qytetit, ne te cilat japin mesim 304 mesues.

Ndersa ne arsimin parashkollor kemi 7 kopshte, 5 publik dhe 2 jopublik ne te ciletr frekuentojne 819 femije nga te cilet 570 ne kopshte me ushqim, ne te cilet punojne 43 edukatore.

Ndaj vleresimi i ketij kontigjenti ka qene maksimal, jo per numrin apo perqindjen qe ze ne



raport me banoret e tjere, por si detyrim per brezin me te ri te qytetit i cili ka aq pretendime, per shkollen dhe kulturen, si brezi i cili do marre stafeten e zhvillimeve ne qytetin tone, ne te gjitha fushat.

Sektori i **kultures** e ka patur si objektiv permbushjen e detyres ne aspektin e veprimtrive kulturore, artistike, historike etj. Keto veprimtari jane zhvilluar ne mjediset e ketyre institucioneve si Pallati Kultures, Biblioteka dhe Muzeu i qytetit.

Nder veprimtarite kryesore te ketyre institucioneve per vitin 2013 evidentojme :

**Pallati i Kultures** si institucioni kryesor i kultures ne qytet, per vitin 2013 ka realizuar 78 veprimtari ose mesatarisht 6 veprimtari ne muaj. Veprimtarite kane filluar qe me 17 janar dhe kane perfunduar ne naten festive te vitit te Ri.

Ndersa ne Galerine e Arteve jane ekspozuar 325 vepra arti nga artist te te gjitha moshave.

Krahas numrit te veprimtarive qe renditem me siper, duhet pranuar fakti se niveli i veprimtarive ka lene per te deshiruar, per faktin se:

- a. Mundesite e financimit per te terhequr grupe cilesore, kane munguar;
- b. Gjendja fizike dhe kushtet e pallatit kultures lene shume per te deshiruar;
- c. Niveli dhe perkushtimi i stafit te Pallatit Kultures ka qene nen mundesite reale qe ka ai staf.

Keto element negativ jo vetem duhen njohur, por me e rendesishme eshte angazhimi, per te permiresuar ndjeshem cilesine e aktiviteteve ne kete institucion publik te rendesishem.

**Biblioteka** edhe gjate vitit 2013 ka qene nje nga institucionet me perfaqesuese, dhe me te konsoliduara te qytetit. Vlerat e ketij institucioni ne nivel qarku tashme jane te konsoliduara, jo vetem per numrin e veprimtarive gjithvjetore, sa per cilesine e aktiviteteve dhe frekuentimin nga intelektual, te rinje e te reja, veterane, pensionist etj.

Frekuentimi i miqve te librit ka shenuar numer te madh rreth 1500 veta. E vecante eshte se rreth 24 % e tyre jane femije ne moshen deri ne 14 vjec, tregues ky mjaft i mire, per mikun e vogel te librit dhe 650 veta (45%) jane ne moshen shkollore.

Mesatarisht ne dite biblioteka frekuentohet nga 115 lexues, nga te cilet jane terhequr mesatarisht 130 libra/dite.

Gjate vitit 2011 ne kete institucion, jane zhvilluar 26 veprimtari kulturore si : promovime, takimer me poete, recensionet, ekspozita etj.

Krahas veprimtarive me te rritur nuk kane munguar veprimtarite me femije.

Sektori i **Muzeut dhe Memorialit**, ka synuar:

- Si çdo vit tjetër edhe gjatë vitit 2013, në rritjen e cilësive të shërbimit ndaj vizitorëve, për tërheqjen e vizitorëve vendas dhe të huaj, ku numri i tyre ka qenë mbi 18000 veta;
- bashkëpunimin me institucione arkeologjike, për vazhdimin e zbulimeve të reja në afërsi të Memorialit dhe gjithë zonën arkeologjike, përfshirë edhe kalatë mejetare;

Ky institucion është kthyer një pikë referimi për çdo vizitor vendas apo i huaj, të cilet në të shumtën e rasteve nuk largohen pa një vizitë në atë mëdij. Gjatë vitit 2013 krahas vizitave të zakonshme janë shënuar edhe ceremoni promovuese siç ishte rasti me Z. Haradinaj.

Nje pune e kujdeseshme behet ne ruajtjen dhe ekspozimin e paisjeve te muzeut te qytetit, por mjedisi ku ata ndodhen eshte mjaft i papershtatshem. Per te rritur vlerat e turizmit kulturor, kerkohet nje investim i vecante per kete sektor si ne rikonstrukcionin e Memorialit dhe krijimin e nje mjedisi serioz, per muzeun e historik dhe etnografik te qytetit.

**Spektori i Sportit**, ka patur si objekt rritjen e cilesise sportive ne 6 lloje sportesh (*futboll, mundje, xhudo, karate, volejball (femra) & boks*) ne te cilin funksionojne 16 ekipe te moshave te ndryshme. Me keto ekipe eshte perfaqesuar qyteti yne, ne te gjitha veprimtarite sportive te kalendarit qe kane patur federatat perkatese.

Ne menyre te vecante vlen te permendet cilesia sportive ne sportin e **xhudo-s** dhe **karate-se**, si sporte te reja dhe pa ndonje pervoje, por qe jemi renditur ne vende nderi. Nje pune me e kujdeseshme eshte bere gjate vitit 2013 me ekipet e 15 vjeçareve dhe te rinjet e mundjes, si shanse per te kthyer traditen e Lezhes nder vite.

Fundviti 2013 ka shenuar ngjitje cilesore te ekipit futbollit i cili i ka te gjitha mundesite te kaloje ne Kat.I-rë.

**Disa probleme te evidentuara:**

- Rritja e cilesise sportive kerkon mjedise cilesore, te cilat mungojne ne qytetin tone;
- Investimet ne sport, perfshire edhe futbollin jane ne nivele mjaft te ulta;
- Terrenet sportive jane ato te 20 viteve me pare;
- Mungesa e mjediseve sportive dhe investimeve, ka varferuar stafet sportive dhe ka ulur ndjeshem cilesine e punes se trajnereve.

**DREJTORIA BURIMEVE NJEREZORE:**

**Ka synuar :**

1. Ne rritjen e nivelit te punes se administrates, ne funksion te rritjes se sherbimit ndaj komunitetit;
2. Ne implementimin e praktikave te reja qe administrata e bashkise te jete bashkekohore ne veprimtarine e saj, ne raport me funksionet qe kryen, ne zbatim te ligjit dhe ne sherbim te komunitetit;
3. Ofrimin e administratës së bashkisë me politikat lokale e rajonale, evidentimin e problemeve te komunitetit dhe venja ne rrugen e zgjidhjes te kerkesave dhe ankesave te ngritura nga ana tyre;
4. Permiresimin e sherbimit ndaj komunitetit, nepermes zbatimit te praktikave te reja sic ishte ngritja dhe funksionimi i Zyres me Nje Ndalese (One Stop Shop)
5. Krijimi i kushteve normale te punonjesve te aparatit te Bashkise dhe institucioneve vartese, per te mundesuar veprimtarine normale te tyre.
6. Prezantimi ne media i arritjeve dhe problemeve qe jane evidentuar ne punen e Bashkise , insitucionet e tjera publike, ne interes te komunitetit lezhjan.

**Nder detyrat qe ka ndjekur kjo drejtori evidentojme :**

- Plotesimin e te gjitha nevojave me personelin e miratuar ne strukturen e vitit buxhetor;

- Ngritjen e nivelit te administrates nepermes kualifikimit te punonjesve, si nepermes veprimtarive kualifikuese ne drejtimin e nepunesve te kualifikuarte administraets bashkise dhe nga bashkepunimi me institucione te specializuara si; Instituti i trajnimeve te Administrates Publike (ITAP), Partner Shqip, USAID; dldp etj.
- Administrimi dhe sistemimi i dokumentacionit arkivor dhe dorezimi i tij sipas etapave ne arkivin e qarkut.
- Organizimi i pritjeve ditore dhe periodike te komunitetit, nepermes sektorit te maredhenjeve me publikun, per te evidentuar problemet e komunitetit, per strehim, punesim, ndihme ekonomike, sherbime publike etj.

Krahasuar me vitin 2013 kemi kete pasqyre te kerkesave dhe ankesave nga qytetaret:

<i>Viti</i>	<i>Kerkesa :</i>	<i>Ankesa</i>	<i>Vertetime</i>
<b>2010</b>	461	333	2 250
<b>2011</b>	840	240	3175
<b>2012</b>	430	120	2650
<b>2013</b>	100	-	2775
<i>Krahasuar/2012</i>	<i>- 230</i>	<i>- 120</i>	<i>+ 125</i>

- Nga sektori i protokollit jane menazhuar **7163 shkresa** nga te cilat 2688 shkresa te hyra.

Krahasuar nder vite jane sipas tabelës:

<i>Vitet</i>	<i>Shkresa</i>		<i>Vertetime</i>	<i>Vendime/ Kryetarit</i>	<i>Urdhera/ kryetarit</i>
	<i>Hyrje</i>	<i>Dalje</i>			
2010	1224	1387	2 250	77	56
2011	2786	1879	3175	64	71
2012	2570	1920	2650	57	63
<b>2013</b>	2688	4475	2775	50	60
<i>Krahasuar</i>	<i>+118</i>	<i>+ 2555</i>	<i>+125</i>	<i>-7</i>	<i>-3</i>

**Si konkluzion:** Rritja e korespondences zyrtare ne hyrje e kryesisht ne dalje ka qene e lidhur me numrin e shkresave te shumta derguar biznesit te vogel si, njoftime, akte bllokime logarie ne banke e me pas zhbllokime.

#### **Disa probleme te evidentuara :**

**Se pari :** Me gjithë ndryshimet e perviteshme ne perberjen e personelit, akoma verhen mangesi, indiferentizem ne kryerjen e detyres, mungese profesioalizmi, pra jemi larg modelit te nje nepunesi profesional dhe intelektual, siç e kerkon koha;

**Se dyti :** Me gjithë kerkesen e vazhdueshme, per nje disipline formale dhe profesionale, akoma nuk eshte krijuar steriotipi i raportit te punes ne zyre me ate ne terren;

**Se treti :** Ndonese jane bëre perpjekjet per kualifikimin e punonjesve, jo vetem nepermes praktikes se vetekualifikimit, por edhe nga bashkepunimi me institucione te specializuara dhe fondacione ne shkalle vendi, akoma mbetet shume per te bëre.

**Se katerti:** Sjellim ne vemendjen e secilit, kerkesen per shfrytezimin e kohes fizike te punes. Mbase duket si e tepert, por vlen te theksohet fakti se tek ndonje individ mungon vullneti per pune dhe mungesa e durimit te qendroje ne zyre. Ndaj rasteve qe abuzohet me kohen dhe cilesine e punes nuk do tolerohet

Keto probleme duhen marre ne forme verejtje per çdo punonjes dhe drejtues sektori ne Bashki.

## **SEKTORI AUDITIT:**

Ka funksionuar si njesi auditimi me dy punonjes. Ky sektor gjate vitit 2013 ka realizuar 12 audite, me tematike te ndryshme.

Nga auditimi jane konstatuar shkelje te disiplines financiare nga sherbimet e kontraktuara me siper marrje te pastrimit dhe gjelberimit ne shumen 1.485.862 leke dhe debitor te prapambetur per kopshtet ne shumen 167.978 leke.

Nga auditimi eshte konstatuar nivel i ulet te ardhurave nga asetet e dhena me qera. E veçanta ne punen e ketij sektori evidentojme raportte e partneritetit dhe bashkepunimit me drejtorine e finances, per te zbatuar mangesite e konstatuara nga auditi dhe rekomandimet e dhena nga ky sektor.

## **INSPEKTORIATI NDERTIMOR URBANISTIK**

Ky sektor ka patur si mision ushtrimin e përgjegjësisë ne kontrollin e territorit, zbatimin e standarteve teknike në fushën e ndërtimit ne zbatim te ligjit “Për Inspektimin e Ndërtimit” dhe akteve nenligjore ne zbatim te tij.

### **Veprimtaria e ketij sektori gjate vitit 2013 ka synuar :**

1. Mbajtjen nen kontroll te territorit të Bashkisë, në zbatim të kerkesave ligjore.
2. Verifikimin dhe kontrollin e çdo procedure të ndjekur nga subjektet që ndertojnë me leje në territorin e Bashkise;
3. Kontrollin e vazhdueshem te territorit arkeologjik, per te parandaluar e bllokuar ndertimet ne zonen A dhe B te Parkut Arkeologjik.
4. Bashkepunimin e perhershem me drejtorine e Planifikimit Territorit dhe Policine Bashkiake, per ndalimin e shkeljeve ligjore ne fushen e ndertimit.
5. Ndërhyrjen në të gjitha rastet kur vërehen shkelje të ligjit, jo vetem per parandalimin, por edhe prishjen çdo ndërtimi qe bie në kundërshtim me planin rregullues të qytetit.

Gjate vitit 2013 eshte evidentuar kjo pune inspektoriati ndertimor urbanistik:

- janë mbajtur 103 akte konstatimi për ligjshmërin e ndërtimit;
- janë dhene 103 vendime pezullim punimesh;
- Jane dhene 99 vendime prishje;
- Janë marre 85 vendime ekzekutimi;
- Jane dhene 3 gjoba, per moszbatim ligjshmerie.

Ndonese jane shenuar mjaft raste te evidentimit, pezullimit, gjoba etj. ky sektor ka patur edhe mangesi, kjo e lidhur me traditen e fushatave elektorale, ku banoret nuk jane korekt me ligjin dhe ndertojne pa leje si te jete pa shtet. Per bllokimin e ndertimeve pa leje eshte angazhuar edhe Policia e Shtetit e cila ka paraqitur kallzime, per invid dhe shoqeri ndertimi. Edhe personeli i ketij inspektoriati, nuk i ka shpetuar kallzimit, per moskryerjen ne kohe te detyres.

## **POLICIA BASHKIAKE**

Ne përberje të se ciles janë 6 polic dhe një inspektor policie, me një mision të rëndësishëm në Bashki, si institucion i zbatimit të akteve administrative dhe mbështetje në të gjithë praktikat ligjore, të sektoreve të tjera.

Ndër detyrat kryesore të realizuara nga Policisë Bashkiake evidentojmë :

- Kryerja e shërbimeve në funksion të ruajtjes së rendit, qetesise dhe mbarevajtjes së jetës në qytet;
- Zbatimin e akteve të nxjerra nga Kryetari dhe Këshilli i Bashkise, si për rendin, qetesine, sigurimin e të ardhurave vendore, lirim të mjedisve publike etj.
- Respektimin e dispozitave ligjore, të cilat rregullojnë veprimtarinë e tregëtimit të shërbimit në mjediset publike;
- Parandalimin e ndotjeve të mjedisit nga subjekte private apo publike dhe marrjen e masave për vendosjen e situatave normale në qytet;
- Zbatimin e rregullave të Kodit Rrugor në aspektin e parkimit të automjeteve private në qytet dhe jashtë vendeve të miratuara nga bashkia etj.

Krahas këtyre detyrave një vend të rëndësishëm në punën e Policisë Bashkiake ka qenë mbështetja ndaj drejtorisë Taksave Vendore, për realizimin e të ardhurave vendore, në funksion të se ciles janë zbatuar 79 urdhera për bllokim aktiviteti.

Në mbështetje të Inspektoriatit Ndertimor, për pezullimin e ndertimeve të paligjshme dhe shembjen e objekteve paleje, për t'i hapur rrugë investimeve publike.

Ndër aspektet e punës së përditshme të policisë ka qenë kontrolli i vazhdueshëm për lirim të hapësirave publike si nga zënjat e lokaleve në afërsi të trotuareve, duke hequr të gjithë tregëtarët ambulant nga mjediset publike.

Zbatimi i detyrës nga ky sektor është shoqëruar me vendosjen e 61 gjobave me një vlerë prej 62.000 leke të arketuara.

Por krahas angazhimeve janë vërejtur edhe vështirësi në kryerjen e detyrës ndër të cilat evidentome :

1. Në pjesën më të madhe të vitit dhe kryesisht në periudhën e verës ka munguar bashkëpunimi me policinë rrugore, për stabilizimin e qarkullimit, kryesisht në periudhën e fluksit të ardhjes së emigrantëve.
2. Disiplina e punës dhe kultura gjatë kryerjes së shërbimit nuk ka qenë gjithnjë në lartësinë e duhur, me norma qytetarie dhe kodin e etikës së policit.

Keto kanë qenë disa mangësi më të cilat është përballur puna e Policisë Bashkiake. E rëndësishme mbetet, jo vetëm evidentimi i tyre, por reflektimi ndaj mangësive të konstatuara dhe përmirësimi i punës në vitin 2014.

## **ZYRA E GJENDJES CIVILE:**

**Si funksion i deleguar me një staf prej dy vetash ka patur si mision :**

1. Të realizojë një shërbim të shpejtë dhe të kulturuar ndaj qytetarëve, për të krijuar një performancë të mirë në komunitet.
2. Përballimi i kërkesave që solli fushata elektorale e zgjedhjeve të përgjithshme,

kryesisht ne zbatim te kerkesave te ligjit, per saktesine e listave zgjedhore, per t'i dhene mundesine çdo shtetasi te shprehe vullnetin etij ne votime etj.

### **Nder arritjet e vitit evidentojme :**

- Si prioritet i kesaj zyra ka qene pergjegjesia ndaj ligjit ne hartimin e listave zgjedhore dhe korektesia ndaj kerkesave te forcave politike, ne te gjitha etapat zgjedhore.
- Perditesimi me korektesi i Rregjistrimit Kombetar te zgjedhjeve, per te menjanuar çdo pretendim te forcave politike.
- Reflektimi i ndryshimet demografike per vitin 2013 te cilat jane:

<i>Viti</i>	<i>Popullsia</i>	<i>familje</i>	<i>lindje</i>	<i>martesa</i>	<i>Fam. Te ardhura</i>	<i>vdekje</i>
<b>2013</b>	29.214	8.397	401	169	181	104

Ndersa si proiritet te Gjendjes Civile per vitin 2014 evidentojme :

- a. Persosjen e sherbimit ndaj qytetareve duke u bere pjese e sherbimit tek Zyra me Nje Ndalese;
- c. Venja ne rrugen e zgjidhjes te sistemit te adresave ne bashkepunim me sektoret e tjere te bashkise.

### **Qendra Kombetare e Rregjistrimit (QKR):**

#### **Ka si mision:**

Rregjistrimin fillestar te bizneseve, ndryshimet ç'rregjistrime, pezullime ose korigjime, dhenje ekstrakte etj.

Nder veprimet me kryesore qe evidentojme per vitin 2013 jane:

- a. Regjistrime te reja per subjekte fizike 145
- b. Regjistrime te reja per biznese juridike 28
- c. Ç'rregjistrime biznesi 66
- d. Ndryshime ne 209 biznese,
- e. Pezullime 62 biznese
- f. Dhenje ekstaktesh 705 biznese etj.

Pozitiv eshte fakti se ndonese ishte nje vit i veshtire per biznesin, raporti i regjistrimit te bizneseve te reja ndaj ç'rregjistrimeve eshte rreth 3 here me i madh.

Problemi qe mund te evidentojme per vitin 2013 ne kete sektor, ka qene mungesa e theksuar ne gjendjen teknike te paisjeve, per te cilat jane vene ne veshtiresi bizneset dhe vete personeli i ketij sektori.

### **Te nderuar pjesëmarres !**

Nepermes kesaj analize u perpoqem te sjellim ne vemendjen tuaj, momentet me te rendesishme te punes se cdo drejtorie e sektori, duke evidentuar arritjet e punes tone, duke paraqitur mosrealizimet me gjithe veshtiresite qe kane sjellur ata ne punen dhe funksionimin e sektoreve kryesore te bashkise.

Evidentimi i mangesive dhe percaktimi i rrugeve me efikase, per vitin 2014 do na ndihmoje, ne percaktimin e masave konkrete per permiresimin e punes tone ne kete vit.

Arritjet do na sherbejne si udherrefyfes, ndersa mosrealizimet si mesim ndaj te ardhmes, per te mundesuar ngritjen e punes se administrates ne nivele akoma me te larta ne vitin 2014, vit te cilin sapo kemi filluar.

E gjithë puna jone per vitin 2014 do udhehiqet me moto-n:

- Krijimin e vizioneve te reja, ne funksion te implementimit te projekteve ambcioze, per zhvillimin e qytetit dhe permiresimin e jetes se banoreve;
- Nepermes praktikave te reja si Zyra me Nje Ndalese (One Stop Shop), te permiresojme ne menyre te ndjeshme, cilesine e sherbimit ndaj komunitetit;
- Mbylljen e projekteve te filluara ne infrastrukturen publike dhe fillimin e projekteve me te rendesishme, per zhvillimin urban te qytetit;
- Vazhdimin e tradites se ketyre viteve, ne rikonstrukcionin e objekteve te arsimit, per t'i krijuar hapësira te reja zhvillimi brezit me te ri te qytetit;
- Zgjerimi dhe permiresimi i mjediseve sportive si ne shkolla dhe klubin sportiv, ne sherbim te masivizimit dhe rritjes se cilesise sportive;
- Krijimin e nje atmosfere besimi tek qytetaret, se bashkia eshte gjithnje ne sherbimin te komunitetit, per te permiresuar kushtet e jetes se tyre ne te gjitha aspektet dhe ne sherbim te te gjitha moshave.

### **Si perfundim :**

Duke evidentuar pergjegjesite tona per mosrealizimet e vitit 2013, jemi te vetedijshem ne perspektivat qe na presin ne punen tone gjate vitit 2014.

Njekohesisht shprehim besimin, mbi mundesite reale te personelit te administrates Bashkise, per te mundesuar realizimin e treguesve te vitit 2014, per te hedhur hapa me cilesor ne zhvillimin e qytetit dhe sherbimin ndaj komunitetit.

**Faleminderit per vemendjen.**

**VIKTOR TUSHAJ**  
**Kryetari i Bashkise**

*Lezhe, me 17.02.2014*